



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 912/2 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M

Nr.226, datë 30.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 912 prot., datë 9.12.2020, të punonjësës ***,
në lidhje me vazhdimin e vlefshmërisë së statusit të nëpunësit**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 912 prot., datë 9.12.2020, punonjësja *****, aktualisht me detyrë specialist bujqësie në Njësinë Administrative Kolsh, Bashkia Lezhë, kërkon nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një qëndrim nëse për të vazhdon të jetë i vlefshëm statusi i nëpunësit civil.

Punonjësja ka ngritur pretendimi se kur ka filluar punë si specialiste e bujqësisë pranë Bashkisë Lezhë, në prill të vitit 2017, ka qenë pjesë e shërbimit civil, status që sipas saj e ka fituar që prej vitit 2002 në Këshillin e Qarkut Lezhë, ku ka kryer detyrën si “Përgjegjëse në DAMT”, deri në korrik 2016, kur është liruar nga kjo detyrë.

Për verifikimin e pretendimit të mësipërm, u shqyrtuan të dhëna nga dokumentacioni i administruar në dosjen e personelit, gjatë inspektimit tematik për evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të

kryer në Bashkinë Lezhë, i cili ka përfunduar me vendimin nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nga përmbajtja e tyre rezultoi se pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, është arritur në përfundimin se emërimi i punonjësës ***** në pozicionin, “*Specialiste e Bujqësisë*”, në Njësinë Administrative Kolsh, pranë Bashkisë Lezhë, me aktin nr. 556, datë 28.9.2018, të Kryetarit të Bashkisë, është kryer pa respektuar procedurën e përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe për pasojë përbën veprim administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Ky konkluzion dhe rendi i veprimeve që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, janë shprehur në dispozitivin e vendimit nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ndërkohë, pasi është njohur me vendimin e mësipërm të Komisionerit, punonjësja në fjalë, ka ngritur pretendimin se konkluzioni i nxjerrë nga grupi i punës, se punësimi i saj është i paligjshëm, është i gabuar pasi ajo është nëpunëse civile që prej vitit 2002 dhe është konfirmuar si e tillë, në pozicionin “*Përgjegjëse në DAMT*”, pranë Këshillit të Qarkut Lezhë, në vitin 2015 edhe në raportin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, hartuar në përfundim të verifikimit të kryer në këtë institucion.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ka kërkuar edhe një herë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë dhe punonjësës në fjalë, të dërgojnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm që disponojnë në lidhje me këtë rast.

Nga ana e institucionit, nëpërmjet postës elektronike, janë dërguar kopje të akteve të emërimit dhe lirimit nga detyra të kësaj punonjëseje, pjesë e shkëputur nga raporti i mbikëqyrjes të ushtruar nga Komisioneri në Këshillin e Qarkut Lezhë, (*pjesa që flitet për këtë punonjëse*) si dhe dokumenti i lëshuar nga Drejtoria e Financës të kësaj bashkie, “*Vërtetim për bazën e vlerësueshme*”, për periudhën 18.04.2017 deri në 31.12.2020.

Nga përmbajtja e akteve të administruara, rezulton se ***** ka qenë nëpunëse civile në pozicionin, “*Përgjegjëse në DAMT*”, pranë Këshillit të Qarkut, Lezhë, detyrë të cilën e ka kryer deri në miratimin e kërkesës së saj për pezullim nga shërbimi civil, për një periudhë 2 vjeçare, kërkesë e cila është miratuar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të këtij institucioni, me aktin nr. 1, datë 18.4.2016.

Më pas, kjo punonjëse me aktin e emërimit nr. 123, datë 18.4.2017, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, është emëruar në detyrën “*Specialiste në Agjencinë e Vadijes dhe Kullimit*”, në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ujitjes, pranë Bashkisë Lezhë (*pozicion pune ky, jashtë shërbimit civil*). Këtë detyrë e ka kryer deri në momentin e riorganizimit të

institucionit, kur është liruar nga detyra me aktin nr. 63, datë 12.2.2018, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe më pas, me aktin nr. 556, datë 28.9.2018, po të Kryetarit të kësaj bashkie, është komanduar në detyrën, “*Specialiste e Bujqësisë*”, në Njësinë Administrative Kolsh, detyrë të cilën vazhdon ta kryejë aktualisht (*pozicion pune ky, pjesë e shërbimit civil*).

Siç shihet nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se punësimi i fundit i punonjësës ***** në Bashkinë Lezhë, në pozicionin pjesë e shërbimit civil, “*Specialiste e Bujqësisë*” në Njësinë Administrative Kolsh, është kryer në kundërshtim me rregullat e legjisllacionit të shërbimit civil.

Në këtë rast, procedura që duhej ndjekur nga nëpunësja dhe njësia përgjegjëse për kalimin e nëpunësës ***** në pozicionin “*Specialiste e Bujqësisë*” në Njësinë Administrative Kolsh, duhej të ndiqte rrugën e mëposhtme:

Kjo punonjëse, në bazë të nenit 56/1, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe të pikës 16, të vendimit nr. 124, dt. 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, duhej të njoftonte njësinë përgjegjëse të Këshillit të Qarkut Lezhë, për ndërprerjen e periudhës së pezullimit (*në qoftë se periudha dy vjeçare, akoma nuk kishte përfunduar*) dhe pas kësaj të kërkonte të merrte pjesë në konkurrimin për lëvizje paralele, në pozicionin “*Specialiste e Bujqësisë*” në Njësinë Administrative Kolsh, pozicion i cili duhej të ishte shpallur për konkurrim nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Lezhë.

Por, duke patur parasysh se në rastin konkret periudha 2 vjeçare e pezullimit, kishte përfunduar (*fillimi në dt. 18.04.2016 dhe mbarimi në dt. 18.04.2018*) dhe nëpunësja nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të rifilluar marrëdhënien e punësimit në Këshillin e Qarkut Lezhë, mundësia e lëvizjes paralele, nuk ekzistonte më dhe nëpunësja në fjalë mund të rifillojë marrëdhënien në shërbimin civil, vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në një procedurë të rregullt konkurrimi për pranim në shërbimin civil, sipas nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Emërimi i saj në pozicionin, “*Specialiste e Bujqësisë*” në Njësinë Administrative Kolsh, pjesë e shërbimit civil, pa respektuar procedurën e mësipërme, është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë, në bazë të nenit 110/1, të ligjit 44/2015 “*Kodi i procedurave administrative i RSH*”, nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike, për rrjedhojë, arrihet në përfundimin se punonjësja *****, aktualisht e ka humbur statusin e nëpunësit civil dhe njësia përgjegjëse e Bashkisë Lezhë, ka vepruar drejt kur ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të saj.

Kjo e drejtë e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Lezhë, bazohet në pikën “ç” të nenit 65, dhe pikën “ë” të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, në momentin e konstatimit të këtij fakti, sipas të cilave, përcaktohet që brenda 5 ditëve, nga konstatimi i

faktit të pavlefshmërisë absolute, ajo duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit dhe lirimin nga shërbimin civil për shkak të ligjit.

Është me vend të theksohet këtu se nëpunësja në fjalë, për tu punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet ti nënshtrohet procedurës konkurruese sipas rregullave të përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 912 prot., datë 9.12.2020, të punonjësës *****, në lidhje me vazhdimin e vlefshmërisë së statusit të nëpunësit civil, në momentin aktual dhe arkivimin e çështjes, pasi punonjësja e ka humbur statusin e nëpunësit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Lezhë dhe punonjësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha